



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FIER

Nr. 13358 Prot.

Fier, më 21.11.2025

Projekt vendim N. 107 D 21.11.2025

“Për miratimin në parim të planvendosjes së pasurive që do të preken nga realizimi i projektit “Zgjerimi i Varrezave Publike” faza e VII -të, fshati Mbyet zk. 2637 Njësia Administrative Portëz Bashkia Fier” me qëllim fillimin e procedurave administrative të shpronësimit të pasurive”.

Këshillit të Bashkisë Fier, sot më dt. 21.11.2025, i paraqitet për shqyrtim materiali i hartuar nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Hartimit të Projekteve, Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Drejtoria e Menaxhimit të Pronave, me qëllim realizimin e projektit “Zgjerimi i Varrezave Publike” faza e VII -të, bazuar në ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 9 pika 1.2, neni 23 pika 7, neni 54 pika “k”, ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, akteve nënligjore për zbatimin e tij, ligjit nr. 9220 dt. 15.04.2004 “Për administrimin e shërbimit të varrimit” të ndryshuar neni 8 si dhe VKM nr. 712 dt. 29.10.2014 “Për miratimin e rregullores teknike “Për projektimin dhe ndërtimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqipërisë”; kryetari i Bashkisë, propozon:

Propozon:

1. Miratimin në parim të planvendosjes së pasurive të paluajtshme pronë private që do të preken nga realizimi i projektit “Zgjerimi i Varrezave Publike” faza e VII – të, fshati Mbyet zk. 2637 Njësia Administrative Portëz Bashkia Fier” me qëllim fillimin e procedurave administrative të shpronësimit të pasurive.
2. Të vijohet me procedurat e mëtejshme administrativo – ligjore për shpronësimin për interes publik të pronarëve që preken nga realizimi i këtij projekti nga ekzekutivi i Bashkisë Fier.

Nd. e Shërbimeve të Gjelbërimit, higjenës
dhe mirëmbajtjes së varrezave publike
Drejtori: L. Taraj

Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit
Drejtori: F. Troka

Drejtoria Juridike
Drejtore: E. Kapllanaj

Drejtoria e Menaxhimit të Pronave
Snl. M. Petushi

KRYETARI
Armando SUBASHI

